




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## KRYETARI I KRYEQYTETIT

Në bazë të nenit 13, nenit 17 pika (f) dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”; nr. 28/04, qershor 2008), nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, si dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110–391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

## V E N D I M

1. Mbyllen për qarkullim të mjeteve motorike:

- 1.1. Rruga “Rexhep Luci” nga tuneli deri tek Sheshi;
- 1.2. Rruga “Qamil Hoxha” nga kthesa e rrugës e deri tek Sheshi, si dhe
- 1.3. Rrugët/rrugicat të cilat kalojnë/dërgojnë në parkun e Universitetit të Prishtinës dhe Bibliotekës Kombëtare.

2. Mbyllja sipas pikës 1 të këtij vendimi nënkupton ndalimin e qarkullimit për të gjitha mjetet motorike duke filluar nga data 01 shtator 2023.

3. Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike e Kryeqytetit për vendosjen e sinjalistikës përkatëse në rrugët e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi.

4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike e Kryeqytetit, drejtoritë tjera të Kryeqytetit dhe organet përkatëse kompetente për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

### I D O R E Z O H E T:

- Drejtorisë për Shërbime Publike;
- Policisë së Kosovës;
- Qendrës për shërbim me qytetarë,
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT  
Përparim Rama

